



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca Plenare**

Seanca nr.2004/02

Prishtinë, më 22 janar 2004, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Xhavit **HALITI**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 102 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Fjala e kryetarit të Kosovës mbi gjendjen e përgjithshme në vend;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për tregti me naftë dhe derivatet e saj-nr.2003/33;
4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për kinematografinë-nr.2003/36;
5. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të Kryesisë nga radhët e komuniteteve të tjera (joshqiptare dhe joserbe);
6. Propozimi i rendit të ditës për seancën tjetër plenare të 29 janarit 2004:
  - 6.1 Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës;
  - 6.2 Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për barazi gjinore;
  - 6.3 Shqyrtimi i dytë i P/ligjit kundër diskriminimit dhe
  - 6.4 Shqyrtimi i parë i P/ligjit për materialin fidanor.

Kryetari kërkoi të procedohet sipas rendit të ditës, të miratuar në seancën e mëparshme.

1. **Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.**
2. Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

## 2. Fjala e kryetarit të Kosovës mbi gjendjen e përgjithshme në vend.

Kryetari e ftoi kryetarin e Kosovës t'u drejtohet deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, theksoi se katër vjet e gjysmë në liri, Kosova ka pasur një progres të madh në të gjitha fushat e jetës, ishin vite të forcimit të lirisë; të sigurisë, të ekonomisë dhe të demokracisë.

Ndërsa sot, pas afër dy vjetësh të ndërtimit të institucioneve shtetërore të Kosovës, ato kanë funksionuar me sukses. Kjo ishte një periudhë e konsolidimit të institucioneve nacionale të Kosovës.

Me këtë rast, do të veçoja punën e Kuvendit të Kosovës, i cili ka miratuar me dhjetëra ligje sistemore dhe ligje të tjera, si dhe rezoluta e deklarata të ndryshme në interes të qytetarëve të vendit tonë. Kuvendi ka kultivuar frymën dhe funksionimin demokratik të institucionit. Po ashtu, edhe Qeveria, me të gjitha ministrinë, ka funksionuar mirë dhe ka arritur të jetë një ekzekutiv i qëndrueshëm.

Presidenti i Kosovës është kujdesur për funksionimin e institucioneve dhe i ka ndihmuar ato me ide e propozime dhe ka luajtur rolin reprezentativ të popullit dhe të qytetarëve në vend dhe jashtë. Prioritet kryesor ka qenë ruajtja dhe forcimi i stabilitetit politik dhe shtetëror të vendit.

Në planin ekonomik, Kosova ka pasur progres. U forcua sektori privat në të gjitha fushat, që sot përbën gjysmën e ekonomisë. Gjatë kësaj kohe, kosovarët kanë treguar shpirtin e tyre ndërmarrës dhe dinamik.

Gjatë kësaj kohe, është forcuar siguria publike. Policia e Kosovës sot ka një kontingjent të qëndrueshëm që duhet të specializohet për detyra të ndryshme.

Trupat Mbrojtëse të Kosovës kanë arritur fazën e organizimit dhe do të kenë përkrahjen tonë në konsolidimin dhe profesionalizimin e tyre, që të jenë forcë e aftësuar për detyrat e veta dhe forcë mbrojtëse në të ardhmen.

Në fushën e arsimit po realizohet procesi i reformave. Që të kemi një arsim kompatibil në zhvillimet ekonomike dhe demokratike të vendit do të angazhohemi për një kompjutorizim të shkollave që çdo fëmijë të ketë qasje dhe të mësojë gjuhën angleze, që po bëhet gjuhë e dytë në Kosovë.

Shëndetësia gjendet në etapën e reformimit dhe do të ndihmojmë që kjo fushë e rëndësishme të stimulohet dhe do të bëjmë përpjekje për vendosjen e mjeksisë së lartë.

Çështjet sociale kanë qenë preokupim për kujdesin ndaj grupeve të caktuara sociale, për punësimin e tyre dhe për ndihma.

Sektori i bujqësisë ka pasur përparime dhe do të angazhohemi për stimulimin dhe subvencionimin e projekteve në këtë degë.

Në fushën e kulturës kemi pasur përparime të qëndrueshme dhe do të bëjmë më shumë për financimin e këtij segmenti me vlerë të vendit tonë dhe të afirmimit të këtyre vlerave kosovare në botë.

Në planin e brendshëm ne do të vazhdojmë të punojmë në integrimin e grupeve etnike apo minoriteteve në shoqërinë dhe në shtetin e Kosovës dhe në garantimin e mbrojtjes së tyre.

Një veprim të përbashkët do ta bëjmë me UNMIK-un rreth bartjes së kompetencave me qëllim të shtimit të efikasitetit të institucioneve të Kosovës.

Në mënyrë të veçantë gjatë kësaj periudhe është forcuar mendimi për njohjen formale të pavarësisë së Kosovës.

Fjalimi i plotë i kryetarit të Kosovës i është bashkangjitur transkriptit.

**Kryetari** dha një pauzë 15 minutshe.

Pas pauzës, **kryetari** theksoi se janë paraqitur shumë deputetë për të diskutuar lidhur me falën e kryetarit të Kosovës, por nuk e sheh të arsyeshme të hapë diskutim për këtë çështje.

### **3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për tregti me naftë dhe derivatet e saj-nr.2003/33.**

**Kryetari** e ftoi ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë ta arsyetojë këtë p/ligj para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Ali Jakupi** theksoi se ky P/ligj definon ngritjen e konkurrencës së lirë dhe lojale në fushën e tregtisë me naftë dhe të derivateve të saj në Kosovë duke mundësuar furnizim të rregullt të tregut të Kosovës, mbrojtje të konsumatorëve si dhe mbrojtje të ambientit. P/ligji parasheh krijimin e këshillit, i cili është i autorizuar të merret me çështjet e liçencimit, me procedura të aplikimit, me krijimin e kushteve normale të mirëvajtjes së tregtimit të naftës dhe të derivateve të saj në Kosovë. Janë të përcaktuara kushtet e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit, si dhe afatet kur do të fillojë funksionimi i këshillit. Këshilli është përgjegjës t'i drejtojë të gjitha aktivitetet dhe punët në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese që kanë të bëjnë me arritjen e qëllimeve të parashtruara e që janë në harmoni me marrëveshjet ndërkombëtare detyruese për Kosovën, me kërkesat e detyrueshme të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe me rregullat e kriteret e Bashkësisë Evropiane. Janë të definuara kushtet për liçencim për të gjitha veprimtaritë që janë të ndërlidhura me importimin, transportin, depozitimin, distribuimin dhe shitjen e naftës e të derivateve të saj në territorin e Kosovës.

Me këtë P/ligj saktësohen mënyrat e veprimit për lëshimin e licencave të reja, për licencat ekzistuese, për përtëritjen e licencave si dhe suspendimin dhe revokimin e tyre.

Me të licencuarit krijohen marrëdhënie kontraktuese me ministrinë përkitazi me rezervat emergjente përderisa është në fuqi liçenca përkatëse.

Janë të përfshira sanksionet që kanë të bëjnë me praktikat mashtruese tregtare për prejardhjen e derivateve të naftës, emërtimin, emrin dhe identitetin e shitësit, çmimin e derivateve dhe përbërjen e cilësisë dhe sasisë së naftës dhe të derivateve të saj.

Në fund, ministri Ali Jakupi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

**Kryetari** e hapi diskutimin për këtë p/ligj.

**Fatmir Sejdiu**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, theksoi se e përkrah në parim këtë p/ligj. Ai i paraqiti disa vërejtje në strukturën e dispozitave të P/ligjit, të cilat gjatë shqyrtimit të tij në Komisionin Funkcional duhen të përmirësohen, siç janë: neni 3, neni

5.6a-d, dhe pika e 8-të e të njejtit nen, neni 9.4, neni 16.3. Janë edhe disa dispozita sanksionuese të p/ligjit, të cilat duhet të saktësohen.

**Dragisha Krstoviq**, në emër të Grupit Parlamentar «Kthimi», tha se në parim e përkrah këtë P/ligj. Ai i paraqiti disa vërejtje lidhur me formulimin e dispozitave ndëshkuese që duhet të përmirësohen gjatë shtyrimit të mëtejshëm të p/ligjit, siç janë: neni 5.6e, neni 15 dhe se shumica e mjeteve të parapara lidhur me dispozitat sanksionuese nuk duhet të përfshihet në këtë p/ligj, ngase këtë materie e ka rregulluar Kodi Penal.

**Bajrush Xhemajli**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e përkrah në parim këtë p/ligj. Vërejtjet e paraqitura si dhe të tjera, shtoi ai, Komisioni Funkcional, kryetar i së cilit është ai, do t'i shqyrtojë dhe inkorporojë në P/ligj me anë të amendamenteve.

**Sebahate Grajçevci**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se e përkrah në parim këtë p/ligj, si dhe i përkrah vërejtjet e paraqitura në këtë p/ligj nga përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të LDK-së.

**Ramadan Kelmendi** theksoi se e përkrah në parim këtë p/ligj. Ai i paraqiti disa vërejtje që i mungonin P/ligjit, sipas tij, siç janë: obligimi për pagesën e tatimeve; uzurpimi i pompave të benzinës; krijimi i kushteve për konkurrencë lojale, mënyra e licencimit; mbrojtja shëndetësore e të punësuarëve në pompat e benzinës etj.

**Ibush Jonuzi** tha se e përkrah në parim këtë p/ligj. Ai i paraqiti disa vërejtje të cilat duhet të merren parasyh gjatë shqyrtimit të p/ligjit, siç janë: obligimet doganore; saktësimi i dispozitave se në çfarë temperaturë duhet të bëhet matja e naftës; dokumentacioni për transportimin e naftës; kuota për limitet e sasive të naftës si dhe kufizimet për dhënie të licencave për tregi me naftë.

**Gani Prekopuca** theksoi se së pari është dashur të miratohet Ligji për energjetikë dhe pastaj Ligji për tregti me naftë. Në P/ligj është dashur të saktësohet se me çfarë valute bëhet importimi i naftës dhe i derivateve të saja si dhe të ceket cila do të jetë akciza që mund të ndikojë në formimin e çmimit.

**Bedri Selmani** theksoi se ky p/ligj nuk i plotëson kriteret themelore profesionale dhe si i tillë nuk krijon funksionalitetin në kushtet e një ekonomie të tregut. Janë tri arsye për këtë: a) P/ligj konceptualisht është i gabueshëm, sepse në vend që të jetë rregullator i mirëfillt i çmimit të tregut të derivateve të naftës ai mirret me rregullat dhe kushtet e funksionimit të kësaj veprimtarie; b) Me rregullat dhe kushtet e funksionimit të kësaj veprimtarie me interes të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit duhet të mirret Ligji për energjetikë; c) Ligji për tregtimin me naftë dhe derivate të saj në të gjitha vendet me ekonomi të tregut është nënligj i ligjit për energjetikë. Ai propozoi që Kuvendi mos ta miratojë këtë p/ligj.

Pas diskutimit, **kryetari** e hodhi në votë këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;  
Kundër-----2;  
Abstenime-----2.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim P/ligjin për tregti me naftë dhe derivatet e saj, dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional, që në afatin kohor prej tri javësh ta shqyrtojnë këtë p/ligj dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

#### **4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për kinematografinë-nr.2003/36.**

**Kryetari e ftoi ministrin e Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve ta arsyetonte këtë p/ligj para deputetëve të Kuvendit.**

**Ministri Behxhet Brajshori** theksoi se ky p/ligj përcakton bazat dhe parimet e organizimit, drejtimit dhe zhvillimit të kinematografisë si formë e të shprehurit artistik. Me këtë P/ligj krijohet Qendra Kinematografike e Kosovës me statusin e personit juridik, në vartësi të Ministrisë së Kulturës.

P/ligji krijon mundësi që me këtë veprimtari të merren të gjithë personat juridik e fizik, vendës e të huaj të regjistruar sipas ligjit, si dhe parashikon mundësinë e bashkëprodhimit të veprave filmike midis partnerëve vendas dhe të huaj.

P/ligji promovon të drejtën e marrjes me veprimtari kinematografike, duke përcaktuar karakterin e parimit të profesionalizmit, si kriter esencial për ushtrimin e saj, dhe veçanërisht nxitë e mbështet prödhimin e filmit vendës, nxitë dhe mbështet aktivitetet për modernizimin dhe zgjerimin e rrjetit të kinemave, krijon e ruan lëndën filmike arkivore, përkatësisht kinotekën, shkruarjen e skenarëve dhe të sajimeve të tjera të dramaturgjisë filmike për regji e xhirim, për montim digjital të pamjeve filmike e të zërit, për animacion, për menaxhimin dhe programimin e kinematografisë, nxitë frymën e konkurrencës pozitive dhe të bashkëpunimit midis producentëve dhe distributorëve.

Në varësi të Ministrisë së Kulturës me këtë ligj krijohet Qendra për Kinematografi e Kosovës, si shërbim publik, me atribute të autoritetit qendror për kinematografi. Kjo qendër do të miratojë buxhetin dhe të hyrat e tjera të saj për tri gjeni të filmit: filmin artistik, dokumentar dhe të animuar. Qendra do të ketë bashkëpunim me institucionet simotra dhe financon prodhimin e filmit kosovar. Pastaj do të regjistrojë dhe licencojë filmat e realizuar ose të importuar, që do të shfaqen në territorin e Kosovës. Me këtë P/ligji parashikohen edhe mënyrat dhe bazat ligjore për dhënien e subvencioneve dhe stimulimeve të tjera me të cilat realizohet interesi publik, kushtet dhe kriteret që duhet plotësuar aplikuesit si dhe detyrimet e kësaj qendre për të raportuar lidhur me aktivitetet e zhvilluara dhe menaxhimin e fondit për kinematografi.

P/ligji normon aktivitetet themelore të ushtrimit të veprimtarisë kinematografike në Kosovë, si veprimtari e interesit publik. Ai njëkohësisht përmbanë edhe dispozitat ndëshkimore për shkeljet e detyrimeve nga ana e të gjithë pjesëmarrësve aktiv në këtë fushë.

Në dispozitat kalimtare dhe të fundit, parashikohen afatet për organizimin e veprimtarisë, afatet për themelimin dhe fillimin e punës së Qendrës Kinematografike të Kosovës, afatet për nxjerrjen e akteve nënligjore në funksion të zbatimit të tij.

Në fund, ministri Behxhet Brajshori i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

**Kryetari** e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij p/ligji në parim.

**Sabri Hamiti**, në emër të Grupi Parlamentar të LDK-së, tha se përkrah në parim këtë p/ligj. Ai i paraqiti disa vërejtje në këtë p/ligj, isç janë: neni 6 lidhur me cenzurën që duhet të hiqet, sipas tij nga teksti i P/ligjit; nenet 27, 28 dhe 29 të kretut të tretë nuk janë materie ligjore por janë program politik që duhet të hiqet nga teksti i P/ligjit. Formimi i Qendrës Kinematografike, si një rregullator institucional, duhet të saktësohet fushëveprimi i saj. Është problematike që Qendra Kinematografike do t'i kontrollojë njerëzit që financojnë me pare të veta prodhim të filmit. Edhe fusha e kulturës duhet t'i përshtatet kushtetve të ekonomisë së tregut.

**Lirak Çelaj**, në emër të Grupi Parlamentar të PDK-së, theksoi se në parim e përkrah këtë p/ligj. Ai pati vërejtje se është një tendencë nga Ministria për ta centralizuar fushën e kulturës.

P/ligji parasheh krijimin e Qendrës Kinematografike të Kosovës, që është hap shumë pozitiv, por funksioni i kësaj qendre do të duhej të ishte decentralizimi dhe depolitizimi i kulturës. Kurse, në këtë p/ligj, neni 41, paragrafi 1 ku flitet për këshillin drejtues të kësaj qendre, thuhet: "Këshilli drejtues përbëhet prej 5 anëtarëve të cilët i emëron ministri për kulturë". Neni 43, i cili ka të bëjë me drejtorin e Qendrës Kinematografike të Kosovës, në paragrafin e saj të parë, ndër të tjera thotë: "Drejtorin e QKK e emëron ministri për kulturë".

"Kosova-filmi" është një institucion që duhet të privatizohet dhe ekzistimi i tij, në të kundërtën në kuadër të Minsitrisë së Kulturës vetëm sa do të ngarkojë buxhetin e saj. Ka mjaft shtëpi filmike private, të cilat do të mjaftojnë për të zhvilluar aktivitetet në këtë fushë.

**Edi Shukriu**, në emër të Komisionit FunkSIONAL, tha se e përkrahë në parim këtë p/ligj. Komisioni gjatë shqyrtimit të këtij p/ligji, të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet do t'i ketë parasysht dhe në formë të amendamenteve do t'ia paraqesë Kuvendit për miratim.

**Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupi Parlamentar të AAK-së, theksoi se e përkrah në parim këtë p/ligj dhe gjatë shqyrtimit të tij do të bëjnë përpjekje të përmirësohet cilësia e tij

**Lubomir Stanojković**, në emër të Grupit Parlamentar "Kthimi", tha se nuk e kontetson nevojën për nxjerrjen e këtij p/ligji, por ky që është propozuar më shumë i përngjan ndonjë dokumenti tjetër se sa një ligj. Ky p/ligj, si edhe shumë të tjere, përmban shumë elemente të shtetësisë.

Grupi Parlamentar "Kthimi", gjatë miratimit të tij, do të abstenojë.

**Gani Sadik**, në emër të Grupit Parlamentar të të tjerëve, theksoi se e përkrah këtë p/ligj dhe do të japin kontributin e tyre gjatë shqyrtimit të tij në Komisionin FunkSIONAL.

**Zyhrije Maloku** tha se e përkrah miratimin e këtij p/ligji në parim, ngase është i hartua mirë dhe ekziston nevoja e madhe për nxjerrjen e tij.

Pas diskutimi, kryetari e hodhi në votë këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për----- shumica;  
Kundër-----1;  
Abstenime-----15.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim P/ligjin për kinematografinë dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë atë në afatin kohor prej tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

##### **5. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të Kryesisë nga radhët e komuniteteve të tjera (joshqiptare dhe joserbe).**

**Kryetari** i informoi deputetët lidhur marrëveshjen e Grupit Parlamentar të të tjerëve për ndërrimin e anëtarit të Kryesisë, për çdo vit, nga radhët e tyre si dhe me kërkesat për emërimin tij/saj.

Kryetari tha se ky grup nuk ka arritur ujdinë për propozimin e vetëm të një kandidati, por i kanë paraqitur tri propozime. Kryesia i ka shqyrtuar propozimet e tyre dhe nuk ka pasur vërejtje në asnjërin propozim, por do të merrë në konsideratë propozimin e koalicionit "Vatan", kurse Kuvendi me një votë formale duhet të deklarohet për emërimin e anëtarit të Kryesisë nga radhët e komuniteteve të tjera (joshqiptare dhe joserbe).

Koalicioni "Vatan" e ka propozuar deputetën Zehra Elezi për anëtare të Kryesisë së Kuvendit.

**Kryetari** nuk lejoi të hapet diskutim lidhur me këtë propozim dhe e hodhi atë në votë dhe rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica;  
Kundër-----0;  
Abstenime-----0.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi propozimin e koalicionit "Vatan" për emërimin e Zehra Elezit anëtare të Kryesisë.

Deputetët e Grupit Parlamentar të komuniteteve të tjera, **Hilmo Kandiç** dhe **Sadik Idrizi** shprehën pakënaqësi lidhur me mënyrën e votimit.

**Hydajet Hyseni**, anëtar i Kryesisë u paraqit për diskutim, por kryetari nuk ia dha fjalën.

**Kryetari** e deklaroi seancën të mbyllur në orën 12:10 minuta.

**Sekretaria e Kuvendit**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

**Akademik Nexhat DACI**